



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

Universiteti Prishtinës Hasan Prishtina

UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

KONTRATË

NR. PROT. 2/551
DATE: 13.11.2020

PJESA I E KONTRATËS

Universiteti i Prishtinës – “Hasan Prishtina” Prishtinë

dhe

“Selmans Network” Adresa: Ulpiana A3, H3/2. Prishtinë

janë pajtuar si në vijim:

TITULLI I KONTRATËS:

“Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapsirave të jashtme dhe të brendshme të Universitetit të Prishtinës Hasan Prishtina”

Numri i prokurimit: 90400/20/059/225

Lënda e Kontrates

- 1.1 Objekti i kontratës është “Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapsirave të jashtme dhe të brendshme të Universitetit të Prishtinës Hasan Prishtina”
Vlera e paralogaritur e shërbimeve për periudhën një mujore është: 58,820.00 euro, me mundësi të shtimit dhe zvogëlimit të hapësirave të UP-së.
- 1.2 Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të Veçanta dhe të aneksit teknik [duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar].
- 1.3 Vendi i pranimit të shërbimeve do të jetë në ç`do kohë dhe në ç`do vend ku edhe e kërkon Autoriteti Kontraktues, Periudha e kontratës do filloj prej datës 12.11.2020 deri me date 12.01.2021, kjo kontrate ndërpritet në momentin e nënshkrimit të kontratës së re, e cila është në procedure të rregullte.

a) Çmim

- a.1 Çmimi i shërbimeve për të do të jetë, gjithsej: 58,800.00 € për muaj, (pesdhjetetjetetqindent), për muaj.
- a.2 Çmimi i shërbimeve për njësi për objektet e brendshme (m² është: 0.62 €), mirëmbajtja e jashtme (m² është 0.02 €), ndërsa pagesa do bëhet ç`do muaj sipas përshkrimit të çmimeve dhe vlera mujore do të jetë konformë m² të përshkruar nga Operatori Ekonomik në dosje të tenderit (specifikimi i çmimeve) të pranuar dhe të aprovuara nga persona kompetent të UP-së për kryerje të knaqshme të shërbimeve.
- a.3 Çmimi që i referohet paragrafit a.1 më lart, do të jetë i vetmi çmim për njësi m² të punës dhe shërbimeve që e ka borxh autoriteti kontraktues ndaj kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe nuk mund të ndryshohet.
- a.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta.
- a.5 Selmans Network, ofron shërbime të pastrimit dhe mirëmbajtjen konform specifikave të kërkuara në dosje të tenderit, në harmoni të plot me planin dinamik, mjetet, dhe artikujt me të cilët kompania ka ofruar, ç`do devijim nga specifikat e kerkuara, plani, mjetet dhe artikujt që operon do jenë bazë për nderprerje të kontratës.

Dorëzimi i dokumenteve për ekzekutim të pagesës

- Raporti mujor i shërbimeve të ofruar i nënshkruar nga njësitë akademike të UP-së (Sekretaret e njësive akademike të UP-së) për kryerje të kënaqshme të shërbimeve, nëse një pjesë e punëve dhe detyrave të punës të kompanisë nuk është kryer në nivelin e kënaqshëm, Autoriteti Kontraktues ka të drejten për mos ekzekutim të shërbimit në fjalë.
- Fatura e vlor dhe e nënshkruar në mënyrë të duhur (mbështetur në raportin e shërbimeve).

Neni 1 Radhitja e dokumenteve të kontratës sipas prioritetit

Kontrata përbëhet nga dokumentet e mëposhtme, sipas prioritetit:

- Marrëveshja e kontratës (PJESA I E KONTRATËS)
- Kushtet e Veçanta duke përfshirë dhe aneksin teknik (PJESA IV E KONTRATË)
- Tenderi Kontraktuesit (që përdor Formularin e Tenderit, pjesa C);
- Kushtet e Përgjithshme (PJESA II E KONTRATËS);



- Dispozita tjera të dosjes së tenderit.
- Oferta Financiare.

Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 2 Komunikimet

Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit, dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

E hartuar në gjuhën shqipe në tri kopje dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një orgjinale për Kontraktuesin, kontrata përbëhet prej 36 fletave.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS - PRISHTINË		"Selmans Network" - Prishtinë	
Emri:	Afrim Bajraktari	Emri:	Kujtim Selmanaj
Pozita:	Drejtor i Prokurimit në UP-së	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	1970	Data:	12.11.2020

UNIVERSITETI I PRISHTINËS - PRISHTINË	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	